

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror - KANS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: KANS-26-1875-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me material promovues

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GRAFO-LONI SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PRISHTINE

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

045999008

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Nazimp Pireva

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Grafo-loni@hotmail.com

(Adresa elektronike)

18.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë është publikuar me dt. 01.04.2026
- Hapja e ofertave: 23.04.2026
- Letra standarde mbi tenderuesin e eliminuar dhe vendimi i AK-se 04.06.2026
- Me datë 09.06.2026 kemi dërguar përmes E-prokurimit kërkesën për rishqyrtim
- Me datë 10.06.2026 kemi pranuar vendimin e AK-se ndaj kërkesës për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Nuk kemi marrë pjesë në hapje. Kemi pranuar procesverbalin e hapjes përmes E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Me datë 09.06.2026, kemi bërë Kërkesën për Rishqyrtim sipas nenit 108A të LPP-se dhe Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, ndërsa AK me datë 10.06.2026 ka kthyer përgjigjën e AK-se duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

AK- Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror – KANS edhe përkundër kërkesës sonë për rishqyrtim nuk ka marrë për bazë faktet e paraqitura nga ne dhe përsëri ka vazhduar me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke bërë shkeljen e radhës në këtë aktivitet të prokurimit. Kërkojmë nga Panelli Shqyrtues i OSHP-së të ndërmarr veprimet e nevojshme sipas LPP-se në mënyrë që të mos lejojë shkeljet e vazhdueshme nga Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK-Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror – KANS- ka bërë shkelje të neneve përkatëse si me poshtë

Shkeljet e Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092,

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Shkeljet e Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2024.

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
- Neni 38 Sqarimi i Tenderëve
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi nr. 1

- Shkelja e Nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik

Neni 1 i LPP-së përcakton se qëllimi i ligjit është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Autoriteti Kontraktues, me rastin e publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues më datë 04.06.2026, ka vepruar në kundërshtim me këtë parim themelor të ligjit.

Operatori ekonomik GRAFO-LONI SHPK ka paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët. Megjithatë, oferta jonë është eliminuar pa bazë ligjore, ndërsa kontrata është propozuar t'i jepet operatorit ekonomik "**Zhermin Durguti B.I.**" me çmim më të lartë.

Një veprim i tillë nuk siguron përdorim efikas të fondeve publike dhe bie ndesh me qëllimin themelor të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi nr. 2

- Shkelja e Nenit 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Me veprimet e veta AK-Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit ajror-KANS, duke shpërblyer me kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë se oferta e jonë ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-se, i cili thotë: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Andaj me këtë shkelje AK - Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit ajror-KANS, nuk ka bërë shfrytëzim të fondeve publike sipas nenit 6 të LPP-së.

Pretendimi nr. 3

- Shkelje e Nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Po ashtu AK-saktesisht komisioni i vlerësimit duke rekomanduar të shpërblehet me kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë se oferta e jonë dhe duke mos e trajtuar ofertën tonë në harmoni të plotë me dispozitën ligjore të LPP-se ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së sepse nuk ka bërë trajtim të barabart të ofertuesve sipas nenit 7 të LPP-se, i cili thotë, shih paragrafin 1 dhe 2, si më poshtë:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-

diskriminuose dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatorëve ekonomik.

Me vendimin e vetë AK- Ofruesi i Shërbimeve të navigacionit ajror-KANS, për të shpërblyer me kontratë një operator tjetër ekonomik me çmim më të lartë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të lartcekura.

Pretendimi nr. 4

Shkelja e Nenit 59, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik

Theksojmë se arsyeja e eliminimit të operatorit ekonomik nuk ka dorëzuar katalogun/brosurën nuk mund të konsiderohet bazë e mjaftueshme për eliminim automatik, pasi në ofertën tonë është dorëzuar Deklarata për Përbushjen e Specifikimeve Teknike, përmes së cilës kemi konfirmuar përputhshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.



Deklaratë për Përputhshmëri me Specifikat Teknike

Titulli: *

Furnizim me material promovues

Nr i prokurimit:

KANB 26 1875 1 2 1

Autoriteti Kontraktues: **Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror - KANS**

Unë, i nënshkruari më poshtë, përfaqësues kompanisë Nazim Pireva, me këtë deklaratë konfirmoj se kompania jonë përmbush të gjitha specifikimet teknike dhe kërkesat profesionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e lartcekur, përshirë:

Kompania jonë zotëron të gjitha kapacitetet teknike për të realizuar me sukses këtë projekt, sipas kërkesave të autoritetit kontraktues.

Kjo deklaratë bëhet në mirëbesim dhe me përgjegjësi të plotë ligjore.

Data: 22.04.2026

Emri dhe Mbiemri: Nazim Pireva

Pozita: Drejtor

Nënshkrimi: vll



Për më tepër, në dokumentacionin e tenderit lidhur me katalogun/broshurën është paraparë mundësia që Autoriteti Kontraktues të kërkojë informata sqaruese. Prandaj, nëse AK ka pasur paqartësi lidhur me katalogun apo broshurat, ka qenë e arsyeshme dhe në përputhje me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores për Prokurim Publik që të kërkojë sqarime shtesë nga operatori ekonomik, e jo të bëjë eliminimin e ofertës sonë pa verifikim të plotë të dokumentacionit të dorëzuar.

Të bashkangjitur e keni edhe Deklaratën për specifika të dorëzuar me ofertë.

Andaj, eliminimi ynë është i pabazuar në gjendjen faktike dhe dokumentare të ofertës, si dhe bie në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, ekonomikitetit dhe efikasitetit në prokurimin publik.

Për më tepër Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësinë dhe obligimin ligjor që në përputhje me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 Rregullores për Prokurim Publik, të kërkojë sqarime shtesë nga operatori ekonomik.

| | | |
|---|------------------------------------|----|
| Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu | Mund të kërkoen informata sqaruese | 69 |
|---|------------------------------------|----|

Pretendimi nr. 5

Shkelja e Parimit të Profesionalizmit

Sipas Nenit 4 të Rregullores për Prokurim Publik, parimi i profesionalizmit kërkon që autoritetet kontraktuese të veprojnë me standarde të larta profesionale, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mirë të prokurimit publik.

- Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me këtë parim, pasi: Nuk ka bërë vlerësim korrekt të dokumentacionit të ofertës sonë;
- Nuk ka marrë në konsideratë dokumentet e dorëzuara;
- Nuk ka kërkuar sqarime për dokumentet;
- Ka nxjerrë vendim të pabazuar në gjendjen faktike dhe dokumentare të procedurës.

Këto veprime tregojnë mungesë të kujdesit profesional gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe përbëjnë shkelje të parimit të profesionalizmit.

PËRFUNDIM

Duke u bazuar në faktet e paraqitura dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, kërkojmë nga OSHP

- I. TË ANULOJË Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues;
- II. Lënda të kthehet në ri-vlerësim në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si Operator Ekonomik kemi material i shkaktuar është:

- Shpenzimin e përgatitjes së dosjes së tenderit,
- shpenzime tjera administrative si dhe dëmtimi i imazhit tonë si një operator ekonomik që jemi në treg që disa vite duke u konsideruar si operator ekonomik i pa përgjegjshëm nga ana e AK-së.
- Shpenzime të përgatitjes së ankesës

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*